



REPUBLIKA E SHQIPËRIE  
MINISTRIA E KULTURËS

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 045 Prot.

Tiranë, më 19.06 2017

VENDIM Nr. 128, datë 05.06.2017

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.9, datë 05.06.2017, pasi shqyrtoi Raportin e gërmimit arkeologjik të shpëtimit në *Trashenë e Linjës së Gazsjellësit Trans Adriatik (TAP), KP 148+050, Uznovë, Berat*,- subjekti "SPIECAPAG Shqipëria", paraqitur nga shoqëri e licencuar në arkeologji "ABKONS" sh.p.k..

VENDOSI:

1. Të miratojë Raportin e gërmimit arkeologjik të shpëtimit në *Trashenë e Linjës së Gazsjellësit Trans Adriatik (TAP), KP 148+050, Uznovë, Berat*,- subjekti "SPIECAPAG Shqipëria", paraqitur nga shoqëri e licencuar në arkeologji "ABKONS" sh.p.k.
2. Të ruhen *In situ* dy vatrat e zbuluara gjatë gërmimit arkeologjik të shpëtimit në *Trashenë e Linjës së Gazsjellësit Trans Adriatik (TAP), KP 148+050, Uznovë, Berat* dhe të merren masa për mbulimin e tyre.
3. Të vijojnë punimet e ndërtimit të tubacionit të Linjës së gazsjellësit TAP, sipas akt-marrëveshjes tre palëshe, të lidhur ndërmjet "TAP AG", shoqërisë së licencuar në arkeologji "ABKONS" sh.p.k. dhe ASHA, të përcaktuar në pikën 3 të vendimit të KKA Nr. 99, datë 14.09.2016, për Fushatën e II (KM 0-69).
4. Investitori duhet të derdhë detyrimet tatimore për mbikëqyrjen e realizuar nga ASHA, sipas tarifave të miratuara me Urdhërin e Ministrit Nr. 384, datë 21.10 2015 dhe përcaktimeve përkatëse të akt-marrëveshjes tre palëshe.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
6. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR  
MIRELA KUMBARQ FURXHI  
MINISTËR



SEKRETAR I KKA  
RUDINA ZOTO

Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu", Nr. 76, Tiranë

Tel: ++355 04 45 35 855

email: [sekretaria.kka@asha.gov.al](mailto:sekretaria.kka@asha.gov.al)

Website: [asha.gov.al](http://asha.gov.al)